



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
Nr. 55 datë 30.09.2024

PËR
“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 55, DATË 29.12.2023, “PËR MIRATIMIN E
BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
PËRFUNDIMTAR 2024-2026 TË BASHKISË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR;

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 30.09.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 54 shkronja “dh”, ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar; ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Udhëzimit Nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; ligjit Nr.10296, datë 8.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; ligji 7961, datë 12.07.1995 ‘Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë’ i ndryshuar, ligjit Nr. 69/2012, “Për Sistemin Arsimitor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit Nr.10352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, i ndryshuar, VKB Nr. 55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar, si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin në numrit total të punonjësve të bashkisë Shkodër, sipas tabelës Nr.11, pjesë përbërese e këtij vendimi.
2. Fondi i pagave për punonjësit shtesë të Bashkisë Shkodër përballohet nga buxheti i bashkisë viti 2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 30 vota

Vota Pro 30

Vota Kundër 12

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 01.10.2024

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR

Oltion LULLI



Institucioni	Kodi institucionit	Numri punonjësve të miratuar	Numri punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	603	20
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	126	
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	228	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	2141042	42	
TOTALI- (Efektet financiare me fondet e veta)		999	20
Gjendje Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)	2141001	20	
TOTALI		1019	20

Bëhet
NUMRI I PUNONJËSVE- Viti 2024

Tabela Nr. 11

Institucioni	Kodi institucionit	Numri punonjësve të miratuar	Numri punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	618	20
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	141	
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	238	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	2141042	42	
TOTALI- (Efektet financiare me fondet e veta)		1039	20
Gjendje Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)	2141001	20	
TOTALI		1,059	20

SEKRETAR
Sabina Danaj

KRYETAR
Oltion LUKAJ

